



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Kontrolli i Lartë i Shtetit Rruga "Abdi Toptani" Nr.1 Tiranë. E-mail: klsh.org.al; web-site www.klsh.org.al

Nr. 1299 / 14 Prot.

Tiranë, më 30.04.2018

V E N D I M

Nr. 36, Datë 30.04.2018

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË PRRENJAS MBI RREGULLSHMËRINË
FINANCIARE NË AKTIVITETIN EKONOMIK
për periudhën nga data 01.01.2016 deri më datën 31.12.2017.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, nisur nga fakti se nga auditimi u konstatuan të meta dhe mangësi në disa fusha të aktivitetit si dhe mos funksionim të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në Bashkinë Prrenjas, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi rregullshmërinë e veprimtarisë ekonomike e financiare sipas kriterëve dhe kërkesave të kuadrit rregullator në fuqi", të ushtruar në Bashkinë Prrenjas, sipas programit të auditimit nr. 1299/1prot., datë 15.12.2017 për veprimtarinë nga data 01.01.2016 deri më datën 31.12.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marjen e masave sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua se për periudhën objekt auditimi nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS). Nga auditimi mbi sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm rezultoi se veprimtaria e administratës së bashkisë nuk mbështetet në strategji zhvillimi vjetore dhe afat mesme, si dhe nuk ka programuar dhe miratuar objektiva

strategjik, por i kryen aktivitetet me plane pune periodike për realizimin e misionit të ngarkuar me ligjin për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore. Në këto kushte edhe vlerësimi dhe menaxhimi i riskut në mungesë të objektivave nuk kryhet. Pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015, funksionimi i administratës së bashkisë dhe Njësive Administrative në varësi të saj, mbështetet ende në rregulloren ekzistuese, si dhe nuk ka gjetur zbatim ligji për statusin e nëpunësit civil. Rregullorja e re e funksionimit të brendshëm të administratës të Bashkisë dhe njësive administrative në varësi të saj pas reformës territoriale është përfunduar dhe miratuar me në datë 22.12.2017, duke reflektuar mangësi të theksuara në funksionim dhe ndarje përgjegjësish gjatë periudhës nën auditim.

Menaxhimi i burimeve njerëzore është në nivele të ulëta. Nga auditimi i dosjeve të personelit, si dhe protokollit të institucionit rezulton se për periudhën objekt auditimi nuk ka kontrata pune individuale ose kolektive sipas përcaktimeve në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë. Në dosje nuk administrohen aktet e procedurës së rekrutimit, si dhe fillimi i marrëdhënieve të punës nuk mbështetet në një vendim rezultat i procedurës së rekrutimit, por në një urdhër të thjeshtë të titullarit të Institucionit. Gjithashtu nuk kryhet vlerësimi periodik si dhe nuk janë parashikuar në asnjë akt masat disiplinore dhe procedurat e dhënies së tyre për punonjësit në veprimtarinë e përditshme. Në këto kushte në mbyllje të aktivitetit vjetor të Bashkisë hartimi i deklaratës së cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm, raportit vjetor për funksionimin e kontrollit të brendshëm dhe pyetësorit të vetëvlerësimit të komponentëve të MFK janë të mangëta dhe nuk pasqyrojnë me vërtetësi realitetin e vlerësimit të gjendjes së sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas përcaktimeve në ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil" (*trajtuar më hollësisht në faqet 11-13 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1Rekomandimi:

a.Nga Kryetari i Bashkisë të ngihet një grup pune me drejtues dhe specialistë, me një program të mirë përcaktuar pune, për vlerësimin e situatës aktuale, përfshi dhe njësitë administrative, dhe të përgatisin mbi bazën e konkluzioneve, strategjinë afatmesme dhe atë vjetore të bashkisë me qëllim përcaktimin sa më real të objektivave që duhet të arrijë Bashkia Prrenjas si dhe planet periodike të veprimit për përmbushjen e objektivave. Të merren masa për caktimin e koordinatorit të riskut për organizimin e punës për identifikimin dhe menaxhimin e riskut në një linjë me hartimin e programit ekonomik.

b.Të merren masa për njohjen nga menaxheri dhe stafi drejtues të MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin e një plan-veprimi konkret, ku të jenë përfshirë hapat që duhen ndjekur dhe masat që duhen marrë për ngritjen e sistemeve të përshtatshme të MFK-së.

c.Sektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa për implementimin e ligjit për statusin e nëpunësit civil në administratën e Bashkisë Prrenjas. Të merren masa për caktimin në pozicionin drejtues të Drejtorisë së Transportit dhe Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale të kapaciteteve të duhura profesionale e institucionale në profilin relevant Inxhinier ose Ekonomist.

Në vazhdimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i funksionimit të auditit të brendshëm, dokumentacionit të dosjeve të vëna në dispozicion rezulton se nuk janë respektuar kërkesat e me ligjin nr. 114/2015, date 22.10.2015 "Per auditimin e brendshem ne sektorin publik"dhe urdhrin e ministrit Financave nr. 100, datë 25.10.2016"Për miratimi e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik", materialet e hartuara nuk janë cilësore dhe jo në përputhje me standartet e auditimit në lidhje me :

- realizimin e planit vjetor i auditimit sipas llojeve dhe objekteve të përcaktuara, ku për vitin 2016 nuk ka plan të auditimeve të miratuar dhe nuk është ndërmarrë asnjë angazhim auditimi dhe për vitin 2017 nga 8 auditime janë realizuar 3 auditime ose në masën rreth 30%;
- mos planifikimin dhe mosrealizimin e një mision auditimi për zbatim rekomandimesh për subjektet e audituara, të përcaktuara këto sipas prioriteteve dhe afateve kohore;

- mungesën e deklaratave të pavarësisë, të takimit prezantues dhe përmbyllës, të pyetësorëve dhe letrave të punës si dhe të inventarit të dosjes dhe kostos së auditimit;
- mosplotësimin e formatit të riskut, si pjesë e programit të angazhimit të auditimit;
- të mos mbajtjes në asnjë rast të akteve të konstatimit për shkeljet e trajtuara me personat përgjegjës;
- kapërcimi i fazës së dërgimit të projektraportit pranë subjektit të audituar, në të gjitha rastet e auditimeve;
- mos detajimin e detyrave të lëna në mënyrë konkrete për çdo rekomandim në Raportet finale;
- mos hartimin nga Përgjegjësi i Auditimit të Brendshëm i memorandumit të auditimit, i cili të përmbajë rekomandimet;
- mungesën e vendimit të Titullarit për miratimin e raportit final dhe memorandumit;
- mos realizimin e auditimeve të thelluara në disa drejtime të tilla që mbartin në vete rrisht të lartë si mbajtja e kontabilitetit, hartimi i pasqyrave financiare, inventarizimi i aktiveve dhe procedurat e prokurimit me vlerë të lartë për investimet. Po kështu është lënë jashtë auditimit administrimi dhe menaxhimi i aseteve (*trajtuar më hollësisht në faqet 13-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Prrenjas të merren masa për dhënien e kapaciteteve të duhura institucionale për rritjen e peshës dhe rëndësisë me qëllim që Zyra e Auditimit të jetë efiçente dhe të zbatojë standardet e auditimit në organizimin dhe funksionimin e saj në të gjitha fazat e procesit të auditimit dhe të sigurojë paraqitjen në mënyrë periodike para menaxhmentit dhe Këshillit Bashkiak të raporteve të përmbledhura për rezultatet e veprimtarisë së auditimit.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2016, kontabiliteti nuk është strukturuar mbi bazë ditaresh respektivë, ditari i veprimeve të ndryshme dhe centralizatori me përjashtim të veprimeve me bankën. Në institucion nuk administrohet evidenca e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara në mënyrë analitike pavarësisht reflektimit të vlerës në total e rakorduar periodikisht, kjo për plotësim të detyrimit mbi pasqyrimin e inventarit kontabël dhe amortizimit periodik të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara. Nga komunikimi me subjektin evidentohet korrespondencë nga financa me strukturat paraardhëse të cilat kanë detyrimin të sigurojnë evidencën e aktiveve gjatë marrjes dhe dorëzimit të detyrës gjë që nuk është realizuar në periudhat paraardhëse dhe është trashëguar me mangësi në këtë drejtim. Si rrjedhim nuk është mbajtur libri inventar me të dhënat e aktiveve të trupëzuara me azhurnimet e përditësuara deri në momentin aktual, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël" dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, kap, III pika 30 (*trajtuar më hollësisht në faqet 16-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Kryetarja e Bashkisë të ngrëjë një grup pune për të analizuar shkaqet e mosrespektimit të kërkesave të vendit të punës në marrjen dhe dorëzimin e detyrës.

3.2 Rekomandimi: Të merren masa për krijimin e regjistrit të aktiveve në bazë të inventarit të fundit. Rregjistri duhet të krijohet në vartësi të llojit të aktiveve, afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit, ku të përfshijë: datën e hyrjes ose të marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritjen të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes deri në daljen e tij jashtë përdorimit.

3.3 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për kuadrin e ngjarjeve ekonomike në ditarë respektiv, ditar të veprimeve të ndryshme dhe libër të madh jo vetëm në format elektronik (në spreadsheet) por dhe në dokumente fizik (hardcopy) me qëllim ruajtjen e administrimit të kontabilitetit, rritjen e sigurisë dhe saktësisë në raportimin periodik financiar.

3.4 Rekomandimi: Kryetarja e Bashkisë të marrë masa për arkivimin në arkivin e institucionit të materialit dokumentar financiar sipas përcaktimeve në kuadrin rregullator për arshivat dhe përcaktimet në kuadrin rregullator për administrimin financiar të Njësive të Përgjithshme të Qeverisjes ku përfshihen Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi hartimin dhe miratimin e buxhetit vendor Bashkia Prrenjas, ka miratuar në Këshillin Bashkiak buxhetin faktik 2016-2017 por nga auditimi i analizës rezulton se është shmangur analizimi i mos realizimit të shpenzimeve të programuara që, për vitin 2017 shkojnë në masën 24% ose në vlerën 171,570,2174 lekë dhe nxjerrja e përgjegjësive reale dhe masat për korrigjim në të ardhmen (*trajtuar më hollësisht në faqet 22 - 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masa për monitorimin periodik të zbatimit të buxhetit dhe të raportoj ecurinë e realizimit të shpenzimeve të programuara duke e shoqëruar me analizë faktoriale dhe duke evidentuar jo vetëm pengesat por dhe përgjegjësinë për mosrealizimin e shpenzimeve dhe, përmbledhësen në fund të vitit, ta raportojë në Këshillin e Bashkisë për diskutim në procesin e miratimit vjetor të buxhetit faktik.

Në vazhdimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se planifikimi i buxhetit për vitin 2016 dhe 2017 është bërë pa llogaritur gjendjen e detyrimeve debitore afatshkurtër të tretëve ndaj bashkisë. Sipas bilancit financiar rezultojnë në vlerën 86,996,644 lekë trashëguar nga viti 2015 dhe në vlerën 137,735,659 lekë në fund të vitit 2016 (*pa llogaritur detyrimet për taksat dhe tarifat vendore të pa paraqitura në kontabilitet në vlerën 22,562,931 lekë për vitin 2016 dhe në vlerën 29,339,851 lekë për vitin 2017*), si dhe gjendjen e detyrimeve kreditore të bashkisë ndaj të tretëve në vlerën 101,091,213 lekë trashëguar nga viti 2015 dhe në vlerën 138,746,930 lekë në fund të vitit 2016, veprim në mos përputhje me kërkesat e metodologjisë së planifikimit dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (*trajtuar më hollësisht në faqet 22 - 38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1 Rekomandimi: Kryetarja e Bashkisë të ngrejë një grup pune me specialistë me përvojë nga të gjithë sektorët për të marrë në analizë detyrimet debitore dhe kreditore dhe në fazën e përgatitjes së PBA dhe buxhetit vjetore 2019 të planifikojë masat për mbulimin e detyrimeve ndaj të tretëve dhe vjeljen detyrimeve të të tretëve ndaj bashkisë me qëllim përmirësimin e performancës në planifikimin, ndjekjen dhe realizimin e buxhetit sipas kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjeve vjetore të buxhetimit dhe udhëzimeve respektive të Ministrisë së Financave.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2017, të ardhurat nga taksat e tarifat vendore nga 54,000 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 51,087 mijë lekë ose 94.6%, me një mosrealizim në vlerën 2,913 mijë lekë. Nga auditimi i treguesve të raportuar konstatohet se disa taksa e tarifa në krahasim me planin kanë tejkalime të ndjeshme, kjo tregon që planifikimi i të ardhurave të

bashkisë për periudhën objekt auditimi nuk është bërë i studiuar, ka pasur rezerva për rritjen e planit të këtyre taksave e tarifave dhe për disa nga taksat e tarifave vendore nuk është patur parasysh realizimi i një viti më përpara (*trajtuar më hollësisht në faqet 80 - 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1 Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrin masa për vlerësimin sa më real të burimeve dhe veçanërisht bazën e tyre me qëllim që të mos evidentohen gjatë vitit ushtrimor tejkalime në disa zëra dhe mos realizime në disa të tjera me një marzh material në vendimmarrje në raport me mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore.

Në vazhdimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer për procedurat e marrjes me qira të objekteve publike për Bashkinë Përrenjas për vitin 2016, është lidhur një kontratë qiraje me nr. 2629 prot., datë 27.10.2016 me qytetarin i përfaqësuar nga F. M. me objekt apartament me një sipërfaqe 47.21 m² dhe afat qiraje 1 vit kundrejt një shpërblimi 30,000 lekë në total. Në vitin 2017 në bazë të vendimit të Këshillit të Bashkisë Përrenjas Nr. 31, datë 14.04.2017 sipas shkresës nr. 35 prot. datë 24.04.2017 është vendosur miratimi për lidhjen e kontratës së qerasë nga Bashkia Përrenjas me z. Gj. K. për ambientin që ai ofron në vlerën e qerasë mujore në shumën 20,000 lekë. Bashkia Përrenjas duhej të merrte masa, duke bashkërenduar punën me të gjitha drejtoritë për plotësimin e dokumentacioneve dhe avancimin e procesit për pajisjen me certifikatë pronësie nga ZVRPP të pronave të saj dhe të mos detyrohet të marrë ambiente me qira për nevoja që mund të plotësohen në asetet e bashkisë. Për marrjen me qira të këtyre ambienteve në përdorim për shkak të mungesës së ambienteve të përshtatshme nga ana e bashkisë duhej të ndiqej procedura sipas kërkesave të VKM nr. 1712, datë 24.12.2008. “Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive shtetërore”, të VKM nr. 529, datë 8.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 100 - 107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1 Rekomandimi: Bashkia Përrenjas të marrë masa për të avancuar sa më shpejt me regjistrimin në ZVRPP të pronave që i kanë kaluar në pronësi a përdorim sipas VKM respektive për vënien e tyre në dobi të sigurimit të të ardhurave për bashkinë. Në raste të plotësimit të nevojave specifike në ambiente të marra me qira nga të tretët të marrë masa për të aplikuar procedurat sipas kërkesave të VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: IMTV Bashkia Përrenjas, për dy vitet 2016-2017 nuk ka hartuar plane mujore për kryerjen e kontrollit në territorin administrativ të bashkisë siç përcaktohet në VKM nr. 862, datë 5.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai vendor.” Aktet e nxjerra nga IMTV Përrenjas, si proces verbale konstatimi, akte pezullimi, vendime prishje, vendime gjobe nuk janë pasqyruar në regjistrer për vitet 2016-2017 bashkë me të mbarturat nga vitet e mëparshme, Gjithashtu nuk ka rakorduar IMTV me financën në lidhje me vendimet e gjobave, kontabilizimin e tyre dhe administrimin e blloqeve të gjobave si letra me vlerë (*trajtuar më hollësisht në faqet 108 - 120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1 Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të merren masa për rakordimin e veprimeve me qëllim sigurimin e transparencës me komunitetin dhe biznesin nëpërmjet mbajtjes, azhurnimit të regjistrimit të akteve administrative të fushës, botimit e reklamimit të veprimtarisë dhe plotësimit të dosjeve respektive me të dhënat e kërkuara për efekt të ndjekjes dhe raportimit. IMTV dhe Drejtoria e Financës të rrisin bashkëpunimin me qëllim regjistrimin në kohë në kontabilitet të vendimeve administrative me gjoba, kontabilizimin e tyre dhe masat për vjeljen në kohë të detyrimeve nga të tretët.

Në vazhdimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në 3 raste në zbatimin e punimeve në kontratat me objekt *“Ndërtimi i linjës së ujësjellësit nga Burimi i Ujit në Galerinë 1070 deri në Depo uji Varovë Skroskë”*, *“Rikonstruksion i ujësjellësit Velçan – Urak njësia Administrative Rrajcë ”* dhe *“Rikonstruksion i rrugëve rurale Rrajcë, Kotodesh dhe Qukës Qendër”*, në Bashkinë Prrenjas, nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor, u konstatua se në dosje nuk ka leje ndërtimi për realizimin e objekteve të mësipërme në kundërshtim me udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”* pika 4 ku citohet se: *“...Për çdo objekt që ndërtohet, sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve administrojnë në kantier dokumentacionin teknik të mëposhtëm: a) lejen e ndërtimit, së bashku me vendimet përkatëse të lëshuara nga organi, i cili e ka këtë të drejtë”* (trajtuar më hollësisht në faqet 50 - 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi. Bashkia Prrenjas, të marrë masa që në vazhdimësi për zbatimin e kontratave për realizimin e investimeve publike të pajisë zhvilluesit me leje zhvillimore.

Në vazhdimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit teknik për zbatimin e punimeve të kontratës me objekt *“Rikonstruksion i rrugëve rurale Rrajcë, Kotodesh dhe Qukës Qendër”* Prrenjas, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Prrenjas dhe shoqërisë *“B. B” SHPK*, u konstatua se raportet e testimit për betonin e ngurtësuar nuk përfaqësonin objektin e kësaj kontrate si dhe datat e hedhjes së betonit rezultojnë të ishin, para datës së fillimit të punimeve në objekt. Testi i betonit të ngurtësuar është kryer për objektin rikonstruksion i rrugës *“Stadiumi i vjetër-Stadiumi i ri, rruga stadiumit, rruga “Koli Vesho” dhe sheshi para stadiumit Berat”* dhe jo për objektin, siç përcaktohet në kontratë (trajtuar më hollësisht në faqet 50 - 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi. Të merren masa nga Bashkia Prrenjas, që shoqëria *“B. B” SHPK* të qartësojë dhe të vetëtojë cilësinë e betoneve të parashikuara në projektin e zbatimit sipas standardeve në fuqi.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Në 1 rast, në kontratën për punë publike me objekt *“Rikonstruksion i ujësjellësit Kotodesh”*, të lidhur mes AK Bashkia Prrenjas dhe BOE *“F.” sh.p.k* dhe *“L.” sh.p.k*, nga auditimi i dokumentacionit tekniko-ligjor, u konstatua se edhe pas 5 muajsh nga data e njoftimit të përfundimit të punimeve objekti nuk është kolauduar dhe marrë në dorëzim. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, ku përcaktohet se: *“Emërimi i kolaudatorit apo i grupit të kolaudimit është detyrë e investitorit, i cili duhet që këtë t’ia komunikojë personit, institucionit që do të merret me kolaudimin dhe seksionit ose zyrës së urbanistikës të rretheve apo bashkive, brenda 30 ditëve nga përfundimi i punimeve të ndërtimit”* (trajtuar më hollësisht në faqet 50 - 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi. Bashkia Prrenjas, të marrë masa për kolaudimin e punimeve të ndërtimit për zbatimin e kontratave për punë publike duke njoftuar personin apo grupin përkatës për kryerjen e shërbimit të kolaudimit brenda 30 ditëve nga data e përfundimit të punimeve.

Në vazhdimësi

12. Gjetje nga auditimi: Mbështetur në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, Kreu VI neni 32, Bashkia Përrenjas ka regjistruar 2 (dy) prona, konkretisht: NP/3/267 me emërtimin -“*Ish konvikti 3kt “Shkolla e mesme Gjeologji-Miniera Përrenjas”* me sipërfaqe 731.82 m², vol 12, fq. 237, datë 12.08.2016 dhe NP. 3/266; me emërtimin “truall” me sipërfaqe 178.48 m² ndërtesë vol 12 fq. 237, datë 1216.

Bashkia Përrenjas duhet të kishte lidhur menjëherë kontrata me 22 familje që banojnë në *ish konvikti 3kt “Shkolla e Mesme Gjeologji-Miniera”*, mbas pajisjes me certifikatë të pronësisë datë 12.08.2016 me sipërfaqe totale 910.3 m². Qytetarët i janë drejtuar Bashkisë me anë të shkresave për lidhjen e kontratës së qirasë ose vazhdimin e procedurave të privatizimit, si dhe zbatimi i VKB nr. 51, datë 23.12.2010 “Për ndarjen e objekteve shtetërore pronë e Bashkisë Përrenjas banesa familjare”, Bashkia sipas VKB për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore tarifa 100 lek/m²/muaj, për taksa mbi kalimin e së drejtës së pronës për pasuritë e paluajtshme, në mënyrë që kjo njësi vendore të mund të realizonte të ardhura nga vënia në funksion e këtyre aseteve, nga mos lidhja e kontratave të qirasë për këto objekte ka sjell të ardhura të munguara në *buxhetin Bashkisë, vlera e pa llogaritur dhe e pa arkëtuar është 1,456,480 lekë.* (Trajtuar në faqet nr. 100 -107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1 Rekomandimi. Bashkia Prrenjas të marrë masa për të ngritur një grup pune ku në përbërje të ketë dhe specialistë të fushës nga institucione kompetente si ZVRPP, të analizojë situatën nëpërmjet bashkëbisedimit me banorët që përdorin për banesë objektet pronë e bashkisë, të lidhë kontrata qiraje dhe në vazhdimësi të fillojë procedurat për privatizimin e tyre përfundimtar.

Menjëherë

13. Rekomandimi. Bashkia Prrenjas të njoftoj Kontrollin e Lartë të Shtetit në të gjitha rastet, që zbatimi i rekomandimeve kalon në proces gjyqësor, si palë e tretë që ka njohuri për çështjen.

Në vijimësi

B.1 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI:

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –Të drejtat e KLSH dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga Titullari i njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 11,933,516 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit të fondeve nr. 4 për vitin 2017 me objekt: “Rikonstrukcion rrugësh për Njësinë Administrative Qukës (Fshatrat Skroskë, Gurrë, Qukës-Skënderbe, Bërzeshtë dhe Pishkash”, nga KVO është skualifikuar pa të drejtë, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi për prokurimin publik, operatori ekonomik “R.” shpk me ofertën më të ulët në shumën 5,408,475 lekë pa tvsh e cila ka sjellë për pasojë dëm ekonomik në shumën

2,724,053 lekë, diferenca nga oferta fituese (8,132,528 – 5,408,475), *trajtuar në detaje në faqen 45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*. Vendimi i KVO është marrë në kundërshtim me nenet 1, pika 2, germa “d” dhe “dh”; nenin 2; Kreu III, nenin 20, nenin 53, pika 4, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe për pasojë është shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit në shumën prej 2,724,053 lekë (*Trajtuar në faqet nr. 38 - 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

1.1. Rekomandimi. Bashkia Prrenjas të marrë masat dhe të ndjekë procedurat administrative e ligjore për arkëtimin të shumës prej **2,724,053 lekë**, nga anëtarët e KVO në përpjesëtim të drejtë për vendimin e marrë në procedurën e sipërcituar në kundërshtim me nenet 1, pika 2, germa d) dhe dh); nenin 2; Kreu III, nenin 20, nenin 53, pika 4, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Subjekti “G.” shpk me NIPT K08., me përfaqësues ligjore z. Rr. T. dhe administrator A. S. prej datës 10.10.2013, ka lidhur kontratë qiraje nr. 312 prot, datë 18.04.2012 (pa noter) me ish-Komunën Qukës përfaqësuar nga ish-Kryetari z. F. K. për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor publik në pronësi të ish-Komunës Qukës (sot Njësia Administrative Qukës) prej 0.55 ha, e cila ndodhet në fshatin Stroskë. Qëllimi i kësaj kontrate është përdorimi i sipërfaqes prej 0.55 ha, për “grumbullim minerali në sipërfaqe”. Afati i kontratës është 10 vjet (05/4/2012 – 18/11/2022), me të drejtë rinovimi çdo vit. Vlera e kontratës është përcaktuar 34,100 lekë, e llogaritur sipas VKM-së nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.10.2010. Vlera e qirasë që subjekti duhet të paguaj për periudhën 2016 –2017, është llogaritur në zbatim të VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.06.2006 të KM “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të Kullotave”, lidhja 2, pika 9/5, për shumën 206,800 lekë më pak nga vlera e kontratës që duhej llogaritur sipas lidhjes 2, pika 14/1 (*Trajtuar në faqet nr. 100 - 106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi. Bashkia Prrenjas të marrë masa për llogaritjen dhe arkëtimin e vlerës prej **206,800 lekë** nga Subjekti “G.” shpk me NIPT K08., me përfaqësues ligjore z. Rr. T. dhe administrator A. S., llogaritur më pak nga përcaktimet në kuadrin rregullator në fuqi, sipërcituar.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Rikualifikimi Urban i rrugës nacionale në qytetin e Prrenjasit*”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **2,214,523 lekë pa t.v.sh.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2052 prot., datë 25.04.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrenjas dhe OE “Z.” SHPK. (*trajtuar më hollësisht në faqet 50 - 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi. Nga Bashkia Prrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **2,214,523 lekë pa t.v.sh** nga operatori ekonomik “Z.” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2052 prot., datë 25.04.2017 me objekt “*Rikualifikimi Urban i rrugës nacionale në qytetin e Prrenjasit*”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Rikonstruksion rrugësh për Nj. A Qukës*”, Prrenjas, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të

ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **96,348 lekë pa t.v.sh.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2129 prot., datë 09.06.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrenjas dhe OE “H.” sh.p.k. (trajtuar më hollësisht në faqet 50 - 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi. Nga Bashkia Prrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **96,348 lekë pa t.v.sh** nga operatori ekonomik “H.” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2129 prot., datë 09.06.2017 me objekt “Rikonstruksion rrugësh për Nj. A Qukës”, Prrenjas, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonceptimi i qendrës së qytetit dhe rikonstruksioni i fasadave qytetit, Prrenjasit”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **437,280 lekë pa t.v.sh.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1994/4 prot., datë 30.06.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrenjas dhe OE “Z.” sh.p.k. (trajtuar më hollësisht në faqet 50 - 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi. Nga Bashkia Prrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **437,280 lekë pa t.v.sh** nga operatori ekonomik “Z.” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 1994/4 prot., datë 30.06.2017 me objekt “Rikonceptimi i qendrës së qytetit dhe rikonstruksioni i fasadave qytetit, Prrenjasit”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rikonstruksion i ujësjellësit Kotodesh”, Prrenjas, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **1,607,522 lekë pa t.v.sh.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2297/4 prot., datë 21.06.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrenjas dhe BOE “F.” sh.p.k dhe “L.” sh.p.k. (trajtuar më hollësisht në faqet 50 - 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi. Nga Bashkia Prrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,607,522 lekë pa t.v.sh** nga BOE “F.” sh.p.k dhe “L.” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2297/4 prot., datë 21.06.2017 me objekt “Rikonstruksion i ujësjellësit Kotodesh”, Prrenjas, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Rehabilitimi i kanalit vaditës Bratile - Stravaj Fshat”, Prrenjas, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **150,860 lekë pa t.v.sh.** Veprimet e mësipërme janë

në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 291 prot., datë 03.02.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrenjas dhe OE "H." sh.p.k. (trajtuar më hollësisht në faqet 50 - 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi. Nga Bashkia Prrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **150,860 lekë pa t.v.sh** nga operatori ekonomik "H." sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 291 prot., datë 03.02.2017 me objekt "Rehabilitimi i kanalit vaditës Bratile - Stravaj Fshat", Prrenjas, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Në objektin "Ndërtimi i linjës së ujësjellësit nga Burimi i Ujit në Galerinë 1070 deri në Depo uji Varovë Skroskë", Prrenjas, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **263,579 lekë pa t.v.sh** si dhe mos aplikim i penalitetit për vonesa në përfundimin e punimeve në vlerën **1,153,157 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2932/3 prot., datë 01.02.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrenjas dhe OE "R." sh.p.k. (trajtuar më hollësisht në faqet 50 - 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Prrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **263,579 lekë pa t.v.sh** nga operatori ekonomik "R." sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2932/3 prot., datë 01.02.2017 me objekt "Ndërtimi i linjës së ujësjellësit nga Burimi i Ujit në Galerinë 1070 deri në Depo uji Varovë Skroskë", Prrenjas, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

Menjëherë

8.2. Rekomandimi: Nga Bashkia Prrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,153,157 lekë** nga operatori ekonomik "R." sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2932/3 prot., datë 01.02.2017 me objekt "Ndërtimi i linjës së ujësjellësit nga Burimi i Ujit në Galerinë 1070 deri në Depo uji Varovë Skroskë", Prrenjas, vlerë kjo e cila përfaqëson penalitetin e pa aplikuar nga ana e Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrenjas ndaj sipërmarrësit të punimeve për vonesa të pa justifikuara në përfundimin në afat të punimeve.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Në objektin "Rikonstruksion i ujësjellësit Velçan – Urak njësia Administrative Rrajcë", Prrenjas, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt në vlerën **62,650 lekë pa t.v.sh** si dhe mos aplikim i penalitetit për vonesa në përfundimin e punimeve në vlerën **263,851 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2254/4 prot., datë 19.06.2017 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrenjas dhe OE "R." sh.p.k. (trajtuar më hollësisht në faqet 50 - 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Prrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **62,650 lekë pa t.v.sh** nga operatori ekonomik "R." sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2254/4 prot., datë 19.06.2017 me objekt "Rikonstruksion i ujësjellësit Velçan – Urak njësia

Administrative Rrajcë”, Prrenjas, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

Menjëherë

9.2. Rekomandimi: Nga Bashkia Prrenjas të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **263,851 lekë** nga operatori ekonomik “R.” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2254/4 prot., datë 19.06.2017 me objekt “*Rikonstruksion i ujësjellësit Velçan – Urak njësia Administrative Rrajcë*”, Prrenjas, vlerë kjo e cila përfaqëson penalitetin e pa aplikuar nga ana e Autoritetit Kontraktor Bashkia Prrenjas ndaj sipërmarrësit të punimeve për vonesa të pa justifikuar në përfundimin në afat të punimeve.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Subjekti “P. 2010” shpk me NIPT L08., me administrator z. Q. P., ka lidhur kontratë qiraje për një periudhë 20 vjeçare duke filluar nga data 18.11.2010 deri 19.11.2030 me Vendim të Këshillit të Komunës nr. 47, datë 02.08.2010 (pa noter) me ish-Komunën Qukës përfaqësuar nga ish Kryetari z. Y. B., për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor publik në pronësi të ish-Komunës Qukës (sot Njësia Administrative Qukës) prej 15.675 m², e cila ndodhet në ish-miniera Pishkash. Qëllimi i kësaj kontrate është përdorimi i sipërfaqes prej 15.675 m², për “Leje shfrytëzimi të shkëmbinjve gëlqeror me objekt ndërtimi i njëjës së inerteve”. Vlera e kontratës është përcaktuar 37,000 lekë, e cila është në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin pyjorë dhe kullotave”, që është 440.000 lek/ha/vit për kohëzgjatjen e kontratës nga 6-10 vjet. Vlera e kontratës është llogaritur sipas lidhja 2, pika 9/5, për 1,372,000 lekë më pak nga vlera e kontratës që duhej llogaritur sipas lidhjes 2, pika 6/1 (*trajtuar më hollësisht në faqet 101 - 102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandimi: Bashkia Prrenjas të marrë masa për llogaritjen dhe arkëtimin e vlerës prej **1,372,000 lekë** nga “P. 2010” shpk me NIPT L08., me administrator z. Q. P., llogaritur më pak nga përcaktimet në kuadrin rregullator në fuqi, sipërcituar.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Sa trajtuar faqen 21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, pasqyra e vendimeve gjyqësore për largime të padrejta nga puna, është konstatuar se nga z. H. H., me detyrë jurist, nuk janë apeluar vendimet e gjykatës së shkallës së parë për dy raste, z. S. H., Vendimi nr. 173, datë 28.02.2017, për shpërblim nga bashkia në shumën 607,466 lekë dhe z. E. D., Vendimi nr. 1099, datë 15.12.2016, për shpërblim nga bashkia në shumën 773,427 lekë, veprime dhe mosveprime këto që kanë shkaktuar **dëmin ekonomik pa mundësi arkëtimi në shumën prej 1,380,893 lekë**.

11.1 Rekomandimi: Bashkia Prrenjas të analizojë rastet sa më sipër dhe, për veprimet dhe mosveprimet e z. H. H., me detyrë jurist, me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë pa mundësi arkëtimi, në shumën prej 1,380,893 lekë, të nxjerrë përgjegjësit dhe të marrë masat përkatëse administrative.

Menjëherë

B.2 MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE:

1-Gjetje nga auditimi: Gjatë vitit 2017, në 4 procedura prokurimi është evidentuar mossigurimi i dobishmërisë maksimale të përdorimit të fondeve publike pasi Autoriteti Kontraktor ka skualifikuar operator ekonomik për aspekte që formalisht përputhen me përcaktimet ligjore por që mund të trajtoheshin lehtësisht si devijime që nuk cenojnë zbatimin e kontratës sipas nenit 53, pika 4 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ku: “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thellësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.” **të cilat do të krijonin mundësinë e shpalljes fitues të OE të skualifikuar me ofertë më të ulët duke siguruar kursimin e fondeve në shumën prej 63,504,498 lekë**, respektivisht 14,464,583 (112,383,638 - 97,919,055) lekë diferenca nga oferta e shpallur fituese në procedurën nr. 1, viti 2017 me objekt: “Ndërtim Ujësjellësi Dritaj-Fanje-Karkavec, Bashkia Prrenjas”; 8,275,621 (36,740,166 – 28,464,545) lekë diferenca nga oferta e shpallur fituese në procedurën nr. 2, viti 2017, me objekt : “Rikonstruksion i shkollës 9-vjecare Qybra Sokoli”; 23,470,918 lekë (76,421,069 – 52,950,151) lekë diferenca nga oferta e shpallur fituese në procedurën nr. 3, viti 2017 me objekt : “Rikonceptim i qendrës së qytetit dhe rikonstruksioni i fasadave të qytetit Prrenjas”; 11,449,989 lekë diferenca nga oferta fituese (67,885,424 – 56,435,445) diferenca nga oferta e shpallur fituese në procedurën nr. 5, viti 2017, me objekt : “Ndërtim trotuari përgjatë rrugës nacionale (ndriçim, gjelbërim etj.)” dhe, 5,843,387 lekë (67,885,424 – 56,435,445) diferenca nga oferta e shpallur fituese në procedurën nr. 6, viti 2017, me objekt : “Rehabilitimi i kanalit vaditës Vija e Madhe Kovanik-Policë, Rrajce Skënderbe”, *(Më hollësisht trajtuar në faqet 38-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1- Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Prrenjas, të marrë masa që KVO në të ardhmen të jenë më fleksibël në vlerësimin e kërkesave për kualifikim, sidomos ato të veçanta, dhe të mos hezitojë të kërkojë informacione shtesë dhe shpjegime nga OE pjesëmarrës në procedurat e prokurimit të Bashkisë Prrenjas duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar duke u mbështetur në përcaktimet e kuadrit rregullator në fuqi për trajtimin e deviacioneve të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës me qëllim menaxhimin sa më ekonomik, eficient dhe efektiv të fondeve publike.

C. MASA ADMINISTRATIVE:

- Referuar shkëlqet të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr.183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë, Kryetarit të Bashkisë Prrenjas t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkëlqet e konstatuara dhe të vendosë masë administrative me gjobë në masën 50,000 lekë për 3 mbikëqyrës punimesh, si më poshtë:

I. Xh. M., për shkëlqet e konstatuara nën cilësinë e mbikëqyrëses së punimeve në objektin: a “Rikualifikimi Urban i rrugës nacionale në qytetin e Prrenjasit”, me sipërmarrës punimesh OE “Z.” sh.p.k, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 2,214,523 lekë pa tvsh si rrjedhojë e diferencave

në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit të punimit të kryer në objekt;

2. F. B., për shkeljet e konstatuara nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin:

a "*Rikonceptimi i qendrës së qytetit dhe rikonstruksioni i fasadave qytetit, Prrenjasit*", me sipërmarrës punimesh OE "Z." sh.p.k, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 437,280 lekë pa tvsh si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit të punimit të kryer në objekt;

3. G. S., për shkeljet e konstatuara nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin:

a "*Rikonstruksion i ujësjellësit Kotodesh*", me sipërmarrës punimesh BOE "F." sh.p.k dhe "L." sh.p.k, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 1,607,522 lekë pa tvsh si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit të punimit të kryer në objekt;

b. "*Rikonstruksion i ujësjellësit Velçan – Urak njësia Administrative Rrajcë*", me sipërmarrës punimesh OE "R." sh.p.k, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 353,501 lekë pa tvsh si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit të punimit të kryer në objekt si dhe prej mos aplikimit të penalteteve për vonesa në përfundimin në afat të punimeve.

D. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", shkronjat "e" dhe "ç" të nenit 1, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenit 24, pika 2 të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Prrenjas, i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për 13 punonjësit e mëposhtëm:

"Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna", neni 12 shkronja (b).

1. **Zj. E. Y.**, në cilësinë e ish- specialist për burimet njerëzore, për vitin 2016.

2. **Z. B. H.** në cilësinë e ish-Drejtorit të Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë nga data 21.03.2016 deri më 18.08.2017.

3. **Z. M. L.** me detyrë Drejtor i Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë.

4. **Zj. D. Ç.** me detyrë specialist finance.

5. **Zj. Z. Ç.** me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe Burimeve Njerëzore

Për shkeljet e mëposhtme:

- Nuk është kryer vlerësimi i punës në fund të çdo viti ushtrimor, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 109, datë 26.02.2014.

- Nuk është dorëzuar detyra me shkrim për azhurnimin e dokumentacionit sipas posteve të punës nga personat që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës sipas përcaktimeve në pikat 50 dhe 51 të VKM nr. 171, datë 26.03.2014.

-Për periudhën e audituar në marrjen në punë të punonjësve nuk janë zhvilluar procedura konkurrimi, pas reformës administrative, në kundërshtim me kërkesat e nenit 22, 23 e 24 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

6. **Zj. K. K.** në cilësinë e ish-Drejtorit i Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë nga data 01.07.2015 deri më 21.03.2016.

7. **Zj. M. M.**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit.

8. **Z. A. G.** me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ardhurave Vendore.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Konstatohet se në miratimin e buxhetit faktik për vitin 2015 nuk është analizuar mos realizimi i shpenzimeve dhe nxjerrja e përgjegjësisë dhe në miratimin e buxhetit faktik për vitin 2016 nuk është analizuar mos realizimi i shpenzimeve në masën 24,18 % dhe vlerën 171,570,217 lekë dhe përcaktimi i përgjegjësisë. Është konstatuar gjithashtu se planifikimi i buxhetit për vitin 2016 dhe

2017 është bërë pa llogaritur gjendjen e detyrimeve debitorë afatshkurtër të tretëve ndaj Bashkisë ku sipas bilancit financiar rezultojnë në vlerën 86,996,644 lekë trashëguar nga viti 2015 dhe në vlerën 137,735,659 lekë në fund të vitit 2016 (pa llogaritur detyrimet për taksat dhe tarifave vendore të paraqitura në kontabilitet në vlerën 22,562,931 lekë për vitin 2016 dhe në vlerën 29,339,851 lekë për vitin 2017) si dhe gjendjen e detyrimeve kreditore të Bashkisë ndaj të tretëve në vlerën 101,091,213 lekë trashëguar nga viti 2015 dhe në vlerën 138,746,930 lekë në fund të vitit 2016, veprim në mos përputhje me kërkesat e metodologjisë së planifikimit dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë".

-Nuk i është kërkuar Këshillit të Bashkisë, ndërhyrje me forcë e Policisë bashkisë, për vjeljen e detyrimeve të subjekteve debitorë, siç parashikohet në nenin 5, shkronja "ç" nën-pika "iii", të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore"

-Nuk është nxjerrë urdhri i bllokimit të llogarive bankare për të gjithë subjektet e biznesit të vogël, por janë mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhër bllokimeve për subjektet e rezultuara debitor bazuar në Raport Auditimin e fundit të kryer nga KLSH si dhe nuk është vepruar me sekuestrimin e pasurive të subjekteve ashtu siç parashikohet në nenin 90, 93 të ligjit nr. 9920, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" Pika 1.

9. Z. M. J., me detyrë Drejtorit të Urbanistikës.

Për shkeljet e mëposhtme:

-Nuk janë marrë masa për zbatimin e Rregullores së Brendshme të Bashkisë, neni 20 pasi në zbatimin e kontratës për 10 investime me vlerë të kontratave të lidhura 164,443,696 lekë pa tvsh, rezultoi një dëm ekonomik në vlerën 6,249,770 lekë pa tvsh si rezultat i punimeve të likuiduara por të pakryera në fakt, prej mos ndryshimit në preventiv dhe situacion përfundimtar sipas zërit faktit të punimeve të kryera si dhe prej mos aplikimit të penalteteve për vonesa në përfundimin në afat të punimeve.

10. Z. G. C., në cilësinë e ish-Drejtorit të Zhvillimit Ekonomik të Bashkisë nga data 01.07.2015 deri më 21.03.2016.

11. Z. A. K., me detyrë inspektor ndërtimi për periudhën nga data 01.01.2016 deri 31.12.2017.

12. Z. O. A., me detyrë inspektor ndërtimi për periudhën nga data 01.01.2016 deri 31.12.2017.

13. Z. F. R., me detyrë inspektor ndërtimi për periudhën nga data 27.09.2017 deri 07.11.2017.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos dërgimin në Drejtorinë e financës të vendimeve të gjobave dhe mos kontabilizimin e tyre mos administrimin e blloqeve si letra me vlerë për vitin 2016- 2017.

- Për veprime në kundërshtim me përcaktimet në ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar me ligjin nr.183/2014, datë 01.04.2013, ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit" i ndryshuar me ligjin nr.10258, datë 25.03.2010, ligjin nr.96/2013, datë 04.03.2013 "Për miratimin e aktiv normativ, me fuqinë e ligjit të VKM nr.1, datë 06.02.2013 "Për pajisjen me leje përdorimi të strukturave të ndërtuara me shkelje të kushteve të lejes së ndërtimit përpara fillimit me efekte të plota të ligjit nr.10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit" i ndryshuar, trajtuar në faqet 115-120 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Shënim: ¹ Në rastin e fillimit të proceseve gjyqësore në funksion të zbatimit të këtij rekomandimi, nga ana e Bashkisë, të kërkohet prezenca e KLSH-së, si palë e tretë në proces gjyqësor, duke e njoftuar me shkresë zyrtare KLSH-në, në lidhje me ecurinë dhe zhvillimet përgjatë procesit gjyqësor dhe në të gjitha shkallët e gjyqimit.

E. Të gjitha procedurat e prokurimit të zhvilluara në Bashkinë Prrenjës dhe zbatimi i kontratave të lidhura prej tyre gjatë viteve 2015, 2016, 2017 dhe 2018 do të riauditohen përsëri brenda 9-mujorit të vitit 2018.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R